

CRNA GORA

Opština Tuzi

Br.Nr:01-031/20- 4432

Tuzi- Tuz, 19.05.2020. godine

MALI I ZI
Komuna e Tuzit

SKUPŠTINA OPŠTINE TUZI

N/r G - dinu Kajoshaj Fadilu - predsjedniku

Predmet: Dostava Predloga Odluke o utvrđivanju javnog interesa za potpunu eksproprijaciju nepokretnosti u KO Tuzi zbog izgradnje kružne raskrsnice kod Katoličke crkve u Tuzima, shodno Generalnom urbanističkom rješenju Tuzi

Shodno članu 60 stav 2 Statuta opštine Tuzi ("Službeni list CG- opštinski propisi", br. 24/19, 05/20) u prilogu Vam dostavljam Predlog Odluke o utvrđivanju javnog interesa za potpunu eksproprijaciju nepokretnosti u KO Tuzi zbog izgradnje kružne raskrsnice kod Katoličke crkve u Tuzima, shodno Generalnom urbanističkom rješenju Tuzi, radi stavljanja u proceduru Skupštine opštine Tuzi.

Za predstavnika predlagača koji će učestvovati u radu Skupštine i njenih radnih tijela prilikom razmatranja ovog materijala određuje se Elviza Redžematović VD Direktorke Direkcije za izgradnju, imovinu i zastupanje opštine Tuzi.

KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT

Z. Fadil Kajoshaj - Kryetar

Lënda: Dorëzimi i Propozim Vendimit mbi përcaktimin e interesit publik për shpronësimin e plotë të patundshmërive në KK Tuz për shkak të ndërtimit të rreth rrotullimit pranë Kishës katolike në Tuz, në pajtim me zgjidhjen urbanistike Gjenerale të Tuzit.

Në bazë të nenit 60 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e MZ- dispozitat e komunës", nr. 24/19, 05/20) bashkëngjitur Ju dorëzoj Propozim Vendimin mbi përcaktimin e interesit publik për shpronësim të plotë të patundshmërive në KK Tuz për ndërtimin e rreth rrotullimit pranë Kishës katolike në Tuz, në pajtim me Kishën katolike në Tuz, në pajtim me aktvendimin Gjeneral Urbanistik të Tuzit, për ta vënë në procedurën e Kuvendit të Komunës së Tuzit.

Për përfaqësues të propozuesit i cili do të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupave punues të tij gjatë shqyrtimit të këtij materialit, përcaktohet Elviza Rexhematović, u.d. Drejtoreshë e Drejtorisë për ndërtim, pronë dhe përfaqësim të Komunës së Tuzit.

S poštovanjem,
Me respekt,



PREDSEDNIK - KRYETARI
Nik Grelashaj

Në bazë të nenit 1 paragrafit 2 dhe nenit 2a të Ligjit mbi shpronësimin ("Fleta Zyrtare e RMZ", nr. 55/00, 12/02 dhe 28/06 dhe "Fleta Zyrtare e MZ", nr.21/08, 30/17 dhe 75/18), neni 38 paragrafi 1 pika 2 dhe 30 e Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr.2/18, 34/19, 38/20) dhe nenit 28 paragrafit 1 pikës 5 të Statutit të komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e RMZ", nr. 24/19, 05/20) Kuvendi i komunës së Tuzit, në seancën e mbajtur më _____ .2020, ka sjellë:

VENDIM

mbi përcaktimin e interesit publik për shpronësim të plotë të patundshmërisë në KK Tuz për shkak të ndërtimit të rreth rrotullimit pranë Kishës Katolike në Tuz, në pajtim me aktvendimin Gjeneral urbanistik të Tuzit.

Neni 1

Përcaktohet interesi publik për shpronësimin e plotë të pasurive të paluajtshme në KK Tuz, për shkak të ndërtimit të rreth rrotullimit pranë Kishës Katolike në Tuz, sipas Studimit të Shpronësimit Nr. 02-5786 / 1 të 22 korrikut 2019 dhe plotësimet e tij nga tetori 2019, të përgatitura nga Administrata për pasuri të paluajtshme të Malit të Zi:

- parcela kadastrale numër 2317/19 ndërtesa 1 me sipërfaqe prej 45 m², numri i parcelës kadastrale 2317/20 ndërtesa 1 me sipërfaqe prej 46 m², nga lista e pronësisë numër 1698 KK Tuz, pronësi e PEPIĆ (HUSEIN) SELJIM në vëllimin 1/1;
- pjesë e parcelës kadastrale me numrin 2291 (numri i parcelës me kusht 2291/2), livadh 6 e klasës 7 m², nga lista e pronësisë numër 478 KK Tuz, pronë e RREGULLIT TË KISHËS KATOLIKE TË SHËN ANTONIT në vëllimin 1/1;
- pjesë e parcelës kadastrale numër 2317/12 (numri kushtëzues i parcelës kadastrale 2317/22) oborri me sipërfaqe 21 m² nga lista e pronësisë numër 1927 KK Tuz, prone e BELEGU IDRIZ KEMAL në vëllimin 1/1;
- pjesë e parcelës kadastrale numër 2317/10 (numri kushtëzues i parcelës kadastrale 2317/25) kopsht me sipërfaqe 12 m² nga lista e pronësisë numër 947 KK Tuz, pronësi e DECEVIĆ (AHMET) BAJRAM NË VËLLIMIN 1/1;
- pjesë e parcelës kadastrale numër 2319/3 (numri kushtëzues i parcelës kadastrale 2319/7) livadh i klasës së 6 me sipërfaqe 43 m² nga lista e pronësisë numër 835 KK Tuz, pronësi e IVANOVIĆ (NOŠ) NIKOLA I IVANOVIĆ (NOŠ) ROBERT në vëllimin 1/2;

- pjesë e parcelës kadastrale numër 2321/1 (numri kushtëzues i parcelës kadastrale 2321/3) livadh i klasës së 5 me sipërfaqe 88 m² nga lista e pronësisë numër 54 KK Tuz, pronësi e BERIŠAJ (DOKA) NIKOLA në vëllimin 1/1.

Shumën e kompensimit të drejtë për pasuritë e paluajtshme nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet nga Administrata e Pasurive të Patundshme të Malit të Zi.

Neni 2

Qëllimi i shpronësimit është ndërtimi i rreth rrotullimit pranë Kishës Katolike në Tuz.

Neni 3

Përfitues i shpronësimit është komuna e Tuzit.

Neni 4

Procedura e shpronësimit të pasurive të paluajtshme të përmendura në nenin 1 të këtij vendimi kryhet nga Administrata e Pasurive të Patundshme - Njësia Rajonale Podgoricë, me propozimin e Drejtorisë për ndërtim, pronë dhe përfaqësim të Komunës së Tuzit.

Nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje për kompensim përpara Administratës së pasurive të patundshme të Malit të Zi - Njësia Rajonale Podgoricë, procedura për përcaktimin e kompensimit të drejtë do të zgjidhet para Gjykatës Themelore në Podgorica.

Neni 5

Mjetet financiare për pagimin e kompensimit të drejtë do të sigurohen nga Komuna e Tuzit nga fondet e Buxhetit Komunal të parashikuara për shpronësimin e pasurive të paluajtshme.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi me ditën e publikimit në “Fletën Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat komunale”.

Numër: 02-030/20-
Tuz, _____.2020

KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT

KRYETARI,
Fadil Kajoshaj

ARSYETIM

Baza ligjore për sjelljen e këtij Vendimi përmbahet në nenin 1 paragrafin 2 dhe 2a të Ligjit për shpronësim, me të cilin është paraparë që interesi publik për shpronësimin e patundshmërive përcaktohet me ligj ose në bazë të ligjit, që përmes shpronësimit ndryshohet pronari në patundshmërinë e shpronësuar (shpronësim i plotë), si dhe nenit 28 paragrafit 1 pikës 5 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, me të cilin është paraparë që në kuadër të kompetencave të veta, komuna përcakton interesin publik për shpronësimin e patundshmërive për realizimin e projekteve me rëndësi lokale dhe nenit 28 paragrafit 1 pikës 5 të Statutit të Komunës së Tuzit me të cilin është paraparë që komuna përcakton interesin publik për shpronësimin e patundshmërive për realizimin e projekteve me rëndësi për Komunën e Tuzit, në pajtim me ligjin;

Këtij organi i është drejtuar Sekretariati për planifikim dhe rregullim hapësinor dhe punë komunale i Komunës së Tuzit, me kërkesën për zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore për shkak të ndërtimit të rreth rrotullimit pranë Kishës katolike në Tuz.

Në pajtim më autorizimet ligjore të parapara në Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale Komuna mund të përcaktojë interesin publik me qëllim të shpronësimit të patundshmërive të nevojshme për ndërtimin e objekteve me interes publik.

Në pajtim me rregulloren e nenit 22 paragrafin 2 të Ligjit mbi shpronësimin, lartësinë e kompensimit ligjor të kompensimit të patundshmërive do ta përcaktojë Administrata për patundshmëritë – njësia vendore Podgoricë, sipas propozimit të Drejtorisë për ndërtim, pronë dhe përfaqësim të Komunës së Tuzit.

Duke pas parasysh se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore si dhe në pajtim me të gjitha ato që u thanë deri më tani, i propozohet Komunës së Tuzit që të sjellë Vendimin mbi përcaktimin e interesit publik për shpronësim të plotë të patundshmërive në KK Tuz për shkak të ndërtimit të rreth rrotullimit pranë Kishës katolike në Tuz, në pajtim me aktvendimin Gjeneral urbanistik të Tuzit.

DREJTORIA PËR NDËRTIM, PRONË DHE PËRFAQËSIM
E KOMUNËS SË TUZIT